

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Ç. me vendbanim në Gj., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.688/2015 të dt.23.01.2018, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.12.2018 në praninë e Prokurores së Shtetit Hava Krasniqi dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë në prezencë të palëve mori publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.Ç., nga i ati A. dhe e ëma S., e vajzërisë H., i lindur më dt.*data e lindjes...*, në fshatin B., Komuna e P. ndërsa tani me vendbanim në Gj., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i martuar-baba i 7 fëmijëve, sipas evidencës penale të kësaj gjykate i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 19.07.2015, rreth orës 18:23 në fshatin B., Komuna e P., në ahengun familjar të mbajtur me rastin e dasmës së djalit të tij M. ka përdor armë zjarri-pistoletën me gas, të markës “Springjel”, me numër serik 001886 duke shkrepur në ajër 6 fishekë dhe pas ardhjes së policisë të njëjtën i'a ka dorëzuar vullnetarisht policisë së bashku me një karikator të zbrazët për të cilën pistoletë i pandehuri nuk ka pasur leje valide nga ana e organeve kompetente konform Ligjit për Armë të cilat nga ana e policisë i janë konfiskuar përkohësisht.

-Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 46, 47, 62, 69, 73, 74, 76, 375 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453, të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin B.Ç., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, të cilin dënim do ta vuaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 62 par.1 dhe 2 nën par.2.7 dhe nenit 69 par.1 të KPRK, të akuzuarit gjithashtu i shqipton këtë:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet arma e llojit Pistoletë me gas, e markës “Springjel”, me numër serik 001886 dhe 1 karikator i zbrazët si mjet i kryerjes së veprës penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/Euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/Euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjykata konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind/Euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 46 të KPRK-së.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.688/2015 të dt.23.01.2018, kundër të akuzuarit B.Ç. me vendbanim në Gj., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.20.12.2018, në të cilën prezantuan Prokurorja e shtetit Hava Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i akuzuari.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se e mbështet pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale që i vihet në barrë sepse pranimi i fajësisë u bë konform nenit 248 të KPRK-së.

Gjykata pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit B.Ç. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, është i moshës së shtyer, për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, kishte sjellje të mira, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, prandaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka zbatuar dispozitat për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit konform nenit 76 par.1 pika 1.5 të KPRK-së dhe ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues-konfiskimin e sendit-të armës dhe gjësendeve tjera të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 62 par.1 dhe 2 nën par.2.7, nenit 69 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar. 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.269/18, me dt.20.12.2018

Zyrtare Ligjore
Mihrie Sheholli-Krasniqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.